

# ÇDO FËMIJË NË SHKOLLË!

Newsletter nr 12, Prill 2016

## Përmbledhje Periodike

Në kuadër të programit “OOSC – Out of School Children”



Nisma “Çdo fëmijë në shkollë” në partneritet me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe UNICEF, zbatohet nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve.

Kjo nismë ka për qëllim monitorimin e situatës aktuale të sistemit arsimor të Shqipërisë lidhur me çështjen e fëmijëve që kanë braktisur shkollën dhe ata që rrezikojnë ta braktisin.

## Çfarë ka arritur nisma deri tani?

- **Publikimi** i Udhëzuesit për monitorimin e fëmijëve jashtë sistemit arsimor në Webiste të 3 Ministrive:  
*MAS:* [http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/statistika/Udhezues\\_M4M\\_dhe\\_U3M\\_Redaktuar\\_12Shkurt2016.pdf](http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/statistika/Udhezues_M4M_dhe_U3M_Redaktuar_12Shkurt2016.pdf)  
*MSH:* <http://www.shendetesia.gov.al/al/baza-ligjore/rregullore-dokumente-udhezues>  
*MPB:* <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/legjislacioni/udhezues/udhezues-per-monitorimin-e-femijeve-jashte-sistemit-arsimor-fjsa&page=1>
- Konfirmimi nga MAS për **gjenerimin e treguesve** ndërkombëtarë të arsimit në sistemin EMIS.
- **Kryqëzimi i listave** të fëmijëve që duhet të ndjekin klasën e parë dhe fëmijëve që janë të rregjistruar në shkollë për vitin shkollor 2015- 2016.
- Intensifikimi i zhvillimit të **punës në terren** për verifikimin e listës së fëmijëve jashtë shkolle sipas Urdhërit të përbashkët 3 Ministror (U3M)
  - Dërgimi i listës së fëmijëve që ende nuk janë regjistruar në klasë të parë nga DAR Durrës në drejtim të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore dhe shefit të Komisarariatit përkatës të policisë
  - Verifikimi në terren i listës së fëmijëve jashtë shkolle nga Njësia e qeverisjes vendore
  - Verifikimi në terren i listës së fëmijëve jashtë shkolle nga Komisarati i policisë
- **Takime periodike** ndër-institucionale dhe brenda institucionit të shkollës për fëmijët jashtë shkolle dhe në rrezik braktisjeje në Durrës.
- **Workshop** nën autoritetin e Institucionit të Prefektit Durrës për koordinimin e identifikimit të fëmijëve jashtë shkolle
- **Workshop me përfaqësuesit e DAR/ ZA** në lidhje me zbatimin e U3M
- Hartimi i manualit të një **trajnimi të plotë shkollor** mbi edukimin cilësor
- Hartimi i **udhëzuesit të mentorimit** të praktikave më të mira për t’u shkëmbyer ndërmjet shkollave të ndryshme.